

**VENDIM**  
**Nr.808, datë 4.12.2003**

**PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT**

*( ndryshuar me Vendimin nr. 736, datë 1.7.2009).*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 6 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Personi fizik, që ushtron profesionin e manovruesit të makinerive të rënda të ndërtimit, duhet të jetë i pajisur me **dëshmi aftësie** ( *ndryshuar me Vendimin nr. 736, datë 1.7.2009*).
2. *Shfuqizohet me Vendimin nr.736, datë 1.7.2009*
3. a) Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shfrytëzimit të Transportit Rrugor të ngrihet komisioni i posaçëm për dhënien e dëshmisë së aftësisë, për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit.  
b) Kushtet dhe kriteret për dhënien e dëshmisë së aftësisë përdoruesve të makinerive të rëndatë ndërtimit, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit përcaktohen në rregulloren, që do të hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe do të miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” ( *ndryshuar me Vendimin nr. 736, datë 1.7.2009*).
4. Kurset teorike e praktike, për përgatitjen e manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike private, që plotësojnë kushtet e parashikuara në rregulloren e përmendur në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij vendimi.” ( *ndryshuar me Vendimin nr. 736, datë 1.7.2009*).
5. *Shfuqizohet me Vendimin nr.736, datë 1.7.2009*
6. Përdorimi i makinerive të rënda pa lejen e manovrimit përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik në ndërtim.
7. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.” ( *ndryshuar me Vendimin nr. 736, datë 1.7.2009*).

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**